



LIGJI PËR BARAZINË GJINORE NË SHQIPËRI:

QËNDRIMET, REZISTENCA DHE ADVOKIMI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE



PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Komente dhe sugjerime mbi Projektligjin Për Barazinë Gjinore nga Awen - Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	4
Letër Informuese për Anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë Lidhur me Projektligjin për Barazinë Gjinore.....	7
Deklaratë Publike e Organizatave të Grave.....	19
Konferencë për Shtyp për Ligjin e Barazisë Gjinore.....	21
Pjesëmarrje në Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë.....	22
Pjesëmarrje në Komisionin për Shëndetësinë dhe Mirëqënien Sociale në Kuvendin e Shqipërisë.....	22
Letër Presidentit lidhur me Dekretimin e Ligjit “Për Barazinë Gjinore”	23
Fushatë Online.....	26
Dalje Mediatike.....	27
Ndërtimi i Koalicionit për Barazinë Gjinore dhe Familjen.....	28
Kërkesë ndaj AMA për verifikimin dhe marrjen e masave për përhapjen e informacionit të rremë në median audiovizive lidhur me LBGJ.....	31
Takime urgjente advokacie dhe Amicus Curiae.....	33



1. HYRJE

Me 6 nëntor 2025, Shqipëria miratoi ligjin e ri “Për Barazinë Gjinore”, me 77 vota pro dhe 36 kundër, pas muajsh debatesh dhe konsultimesh mes organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve dhe institucioneve. Ky ligj përmirëson atë të vitit 2008 duke e përditësuar me standardet e Bashkimit Europian dhe Konventës së Stambollit. Konsultimi publik qëndroi i hapur për një muaj në regjistrin elektronik, ku u regjistruan më shumë se 1400 vizitorë. Organizata të shoqërisë civile përfshirë rrjetet në mbrojtje të gruas, grupe për të drejtat e njeriut, ekspertë dhe aktivistë dërguan komente dhe sugjerime si edhe u bënë pjesë aktive e në seancave dëgjimore në komisionet parlamentare.

Një letër informuese iu dorëzua të 140 deputetëve të kuvendit, si dhe u zhvilluan takime me institucionet e pavarura si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Objektivat reale të ligjit u komunikuan publikisht në mediat sociale dhe tradicionale, si përgjigje të fushatave të dezinformimit.

Mbi 20 organizata publikuan letra të hapura dhe morën pjesë në konferenca për shtyp për të treguar se beteja për barazi gjinore është një angazhim i përbashkët.

Një letër e hapur iu drejtua Presidentit të Republikës, si një thirrje për dekretimin e ligjit dhe mbrojtjen e parimeve të tij.

Beteja për këtë ligj është betejë për dinjitetin dhe sigurinë e çdo personi që është ndjerë i padukshëm, i tallur, i pambrojtur.

Në këtë dokument do të gjeni të pasqyruara gjithë hapat e mësipërme, që AWEN së bashku me organizatat e tjera të shoqërisë civile ka ndërmarrë.



2. KOMENTE DHE SUGJERIME MBI PROJEKTLIGJIN PËR BARAZINË GJINORE NGA AWEN - RRJETI I FUQIZIMIT TË GRUAS NË SHQIPËRI DREJTUAR MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Drejtuar: Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Nga: AWEN - Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

Data: 07.04.2025

AWEN e vlerëson nismën për hartimin e Projektligjit për Barazinë Gjinore si një hap të rëndësishëm për promovimin dhe garantimin e barazisë gjinore në Shqipëri. Po ndajmë komentet dhe sugjerimet tona me qëllim forcimin e dispozitave të projektligjit dhe garantimin e zbatueshmërisë të tij.

Komente dhe Sugjerime

Përcaktime më të qarta dhe përfshirëse në terminologji

- **Diskriminimi i tërthortë:** Nevojitet qartësim mbi mekanizmat, e identifikimit dhe më tej të adresimit të diskriminimit të tërthortë, si dhe shembuj praktikë në sektorë të ndryshëm.
- **Punë e papaguar dhe ekonomia e kujdesit:** Ligji ende nuk shprehet dhe duhet të njohë dhe vlerësojë punën e papaguar të grave, veçanërisht në sektorin e kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit. Këtu mund të përfshihen masa për vlerësimin dhe kompensimin financiar të kësaj pune dhe duhet/mund të parashikohen kosto financiare. Ka modele dhe praktika të ngjashme në vendet europiane lidhur me këtë si vendet nordike: Norvegji, Suedi, Finlandë, si edhe Gjermania, Franca të cilat kanë njohur dhe mbështetur punën e papaguar të grave nëpërmjet politikave të tilla si: kreditime për pensionet, pagesa dinjitoze për kujdestaret, etj.
- **Gjuha e ndjeshme gjinore:** Përkufizimi duhet të sqarojë se si do të zbatohet në fushën e edukimit, administratën publike, dhe media. Duhet marrë parasysh që nevojiten kurrikula në arsimin e të gjitha niveleve të cilat informojnë rreth gjuhës së ndjeshme gjinore apo pabarazive gjinore e shoqërore. Në administratë nevojiten politika të brendshme si edhe mekanizma monitorues për mediat. Ekzistuesët nuk janë të mjaftueshëm dhe nuk funksionojnë.



Përfaqësimi i barabartë gjinor dhe masat

- **Vendosje e kuotave të qarta dhe objektivave të matshme:** Ligji duhet të përcaktojë mekanizma konkretë monitorimi për përfaqësimin e barabartë gjinor në institucione publike dhe private duke përfshirë edhe nivelet drejtuese, pavarësisht kontekstit aktual ku situata mund të paraqitet pozitive sa i takon kuotës.
 - **Përfaqësimi në sektorin privat:** Ka nevojë për qartësim mbi detyrimet e sektorit privat për barazinë gjinore dhe masat monitoruese apo raportuese në raste të shkeljeve dhe abuzimeve.
 - **Masat e përkohshme:** Ligji duhet të përcaktojë afate të qarta dhe kushte për heqjen e masave të përkohshme sapo të arrihet barazia faktike.

Masa për barazinë gjinore në tregun e punës

- **Paga e barabartë për punë të barasvlershme:** Ligji duhet të përfshijë/përmbajë kritere konkrete për vlerësimin e punës së barabartë dhe sanksione të caktuara në rastet e shkeljeve.
- **Ndëshkime të qarta për shkeljet e ligjit:** Sugjerojmë qartësimin e sanksioneve për subjektet që nuk respektojnë dispozitat e ligjit në mënyrë që të sigurohet zbatueshmëri më efektive.

Mekanizmat e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies

- **Institucione të forta mbikëqyrëse:** Ka nevojë për forcimin e rolit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe krijimin e një mekanizmi të pavarur mbikëqyrës.
- **Pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile:** Mund të konsiderohet në ligj përfshirja formale e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të ligjit duke patur parasysh eksperiencën e tyre në këtë fushë.
- **Raportimi dhe transparenca:** Ligji mund të përfshijë periudha të rregullta raportimi mbi progresin e masave për barazinë gjinore, gjë e cila ndodh në praktikë por veçanërisht duke përfshirë analiza krahasimore, duke përcaktuar periudhat.

Neni 7. Masat e përgjithshme për sigurimin e barazisë gjinore:

Rekomandohet të shtohet si masë e përgjithshme edhe sigurimi i monitorimit të zbatimit të kuadrit ligjor, politik dhe institucional lidhur me masat/veprimet konkrete të marra për arritjen e barazisë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit për shkak të gjinisë.



Neni 9. Masat e veçanta

Rekomandohet të rishikohet gjuha në pikën b: *Lehtësimin e ndihmës për personat, që kanë përgjegjësi të veçanta në familje, për shkak të përkujdesjes së përditshme ndaj anëtarëve të paaftë të familjes, për shkak të moshës, paaftësisë fizike apo mendore ose për shkaqe të tjera paaftësie.*

Sipas legjislacionit tonë në përdorimin e termit “persona me aftësi të kufizuar” ose “aftësi e kufizuar fizike apo mendore”.

Të përcaktohet pala përgjegjëse për miratimin e një mase/masave të veçanta dhe vlerësimin periodik të situatës për rishikimin e masave të veçanta.

Neni 13. Të dhënat statistikore gjinore

Të shtohet edhe roli i institucioneve/strukturave të pushtetit vendor në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave dhe statistikave gjinore.

Neni 16. Këshilli i Ministrave

Të shtohet roli i Këshillit të Ministrave lidhur me miratimin e një mase të përkohshme dhe vlerësimin periodik të situatës për rishikimin e këtyre masave.

Neni 21. Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Të shtohet roli i njësisë së vetëqeverisjes vendore lidhur me buxhetimin gjinor, siç paraqitet edhe me lart, pushteti vendor ka një rol të rëndësishëm që angazhimet e ndërmarra politike për arritjen dhe respektimin e barazisë gjinore nga qeverisja, të reflektohen dhe realizohen në praktikë nëpërmjet buxhetit në nivel lokal.

Neni 22. Nënpunësi i Barazisë Gjinore

Nënpunësi i barazisë gjinore duhet gjithashtu të ketë edhe edukimin universitar specifik në fushën e barazisë gjinore, në shtesë të formimit dhe njohurive specifike në këtë fushë.

Nënpunësi i barazisë gjinore duhet të jetë pjesë e diskutimeve lidhur me buxhetimin gjinor, në nivel të pushtetit vendor - ai/ajo duhet të luajë një rol të rëndësishëm në të gjitha fazat e hartimit të buxhetit për të siguruar një buxhetim gjinor.

Gjithashtu, monitorimi përgjatë zbatimit të programeve buxhetore është i rëndësishëm.

Neni 26. Përgjegjësitë e punëdhënësit për mbrojtjen e punëmarrësit nga dhuna, diskriminimi, ngacmimi dhe shqetësimi seksual

Të shtohet edhe detyrimi i punëdhënësit për të siguruar pagë të barabartë për punë të barasvlershme.



3. LETËR INFORMUESE PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË SHQIPËRISË LIDHUR ME PROJEKTLIGJIN PËR BARAZINË GJINORE

Të nderuar/a deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Në kuadër të procesit të konsultimeve mbi Projektligjin “Për Barazinë Gjinore” (PLBGJ), dëshirojmë t’ju informojmë për qëllimet, përmbajtjen dhe rëndësinë e këtij projektligji, si dhe të qartësojmë disa keqkuptime që kanë qarkulluar së fundmi në opinionin publik.

Informacioni më poshtë ndahet nga **Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (GADC)** dhe nga **Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)** në konsultim të ngushtë me ekspertë ligjorë të fushës së ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe mbështetur nga 25 organizata të shoqërisë civile dhe mbrojtje të drejtave të njeriut.

Një ligj për familjet shqiptare, drejtësinë dhe zhvillimin e vendit:

Ky projektligj nuk është një nismë ligjore kundër familjes, traditës apo vlerave morale të shoqërisë shqiptare. Siç do të argumentojmë në vijim, kjo nismë që synon të forcojë drejtësinë, respektin dhe mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat e Shqipërisë në çdo fushë të jetës, si punësim, arsim, shëndetësi, media dhe jetën publike është mbi të gjitha një nismë për familjet shqiptare.

Barazia gjinore është themel i demokracisë dhe i stabilitetit social. Ajo përkthen në praktikë parimet kushtetuese dhe angazhimet e Shqipërisë ndaj së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për të dhe procesit aktual të integrimit evropian.

Si u zhvillua projektligji?

Projektligji “Për Barazinë Gjinore” është rezultat i një procesi të gjerë, gjithëpërfshirës dhe transparent të konsultimit ndërinstitucional dhe publik, të udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me kontributin e drejtpërdrejtë të:

- Institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore;
- Organizatave të shoqërisë civile dhe rrjeteve të grave;
- Ekspertëve të fushës së të drejtave të njeriut dhe të barazisë gjinore;
- Përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare, përfshirë Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Agjencitë e OKB-së, si dhe partnerë të zhvillimit dypalësh e shumëpalësh.



Ky proces është zhvilluar në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke reflektuar qartë ndër të tjera:

- Rekomandimet e vitit 2023 për Shqipërinë të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW);
- Detyrimet që burojnë nga Acquis i Bashkimit Europian, në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE;
- Parimet themelore të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), veçanërisht garancitë e nenit 14 mbi ndalimin e diskriminimit dhe Protokollin nr. 12 për mbrojtjen e barazisë;
- Angazhimet e Shqipërisë ndaj Konventës së Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) dhe rekomandimet e vitit 2024 të Grupit të Ekspertëve të kësaj Konvente (GREVIO) ndaj Shqipërisë, si dhe strategjitë kombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Projektligji përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përmbushjes së detyrimeve pozitive ndërkombëtare të Shqipërisë, forcimit të shtetit të së drejtës dhe ndërtimit të një shoqërie më të drejtë, më përfshirëse dhe më dinjitoze për të gjithë qytetarët, gra e burra, vajza e djem.

Përputhshmëria e projektligjit me kuadrin ndërkombëtar ligjor të të drejtave të njeriut dhe të Bashkimit Europian

Projektligji “Për Barazinë Gjinore” (2025) është pjesë e procesit të përmirësimit dhe harmonizimit të kuadrit ligjor kombëtar në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe kërkesat e integritit evropian, në raport me të gjithë qytetarët shqiptarë.

Ky projektligj ndjek të njëjtat linja dhe lidhet ngushtë me:

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030, që e trajton barazinë gjinore si kusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe forcim të institucioneve demokratike;
- Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, e cila përcakton ndërhyrje ligjore për arritjen e barazisë faktike;
- Planin Kombëtar të Integritit Evropian 2024-2026, që parashikon në mënyrë të qartë nevojën për ndërhyrje në kuadrin ligjor të barazisë gjinore;



- Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, veçanërisht nenin 99, që parashikon bashkëpunim në fushën sociale dhe integrimin e parimeve të barazisë gjinore në politikat kombëtare.

Projektligji “Për Barazinë Gjinore”, i cili përmban 52 nene të ndara në 8 pjesë, përfaqëson një hap cilësor nga niveli deklarativ i parimeve të barazisë gjinore drejt një niveli zbatues dhe praktik të tyre, duke krijuar një bazë të përditësuar parimore dhe institucionale në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18 për mbrojtjen nga diskriminimi dhe nenet 5, 116 dhe 122 për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme, si pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara që kanë përparësi ndaj kuadrit ligjor kombëtar, të renditura në hierarkinë e ligjeve në Shqipëri direkt pas Kushtetutës);
- Ligjin nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, që ndalon diskriminimin, ndër të tjera, për shkak të gjinisë;
- Acquis të Bashkimit Europian, përfshirë Direktivën 2000/78/EC, Direktivën 2006/54/EC, Direktivën 75/117/EEC, Direktivën 76/207/EEC dhe Direktivën 97/80/EC, që vendosin standardet e trajtimit të barabartë, pagës së barabartë dhe përmbysjen e barrës së provës;
- Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Çdo Forme Diskriminimi ndaj Grave (CEDAW), Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 40 (2024) për përfaqësimin e barabartë në vendimmarrje;
- Konventën e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) dhe gjetjet e grupit të ekspertëve (GREVIO) të vitit 2024 për Shqipërinë;
- Konventën nr. 190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës;
- Kartën për të Drejtat Themelore të BE-së (nenet 20-38); Traktatin e Bashkimit Europian (TBE) dhe Traktatin për funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE);
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (OZHQ 1, 3, 5, 6, 10, 11, 16).



Gjithashtu, projektligji siguron harmonizim horizontal të standardeve të mbrojtjes ligjore me legjislacionin e pas vitit 2008 (miratuar ose ndryshuar), përfshirë Ligjin për Buxhetin e Shtetit, Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore, Kodin e Punës dhe Kodin e Mediave Audiovizive, Ligjin për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti dhe Ligjin për Inspektimin Shtetëror, duke garantuar koherencë mes instrumentave ligjore e institucionale dhe efektivitet në zbatim.

Lidhur me përkufizimin e konceptit të “gjinisë” në projektligj:

Përkufizimi mbi gjininë që ka shkaktuar shqetësim publik është ky:

“Gjini”, sipas këtij ligji ka kuptim gjithëpërfshirës në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit lidhur me identitetin dhe shprehjen gjinore.

Ky përkufizim mbështetet në standardet ndërkombëtare dhe europiane që njohin konceptin gjithëpërfshirës të gjinisë si kategori sociale e juridike, që lidhet me rolet, sjelljet dhe atributet gjinore.

Ky koncept gjithëpërfshirës i gjinisë:

- Sanksionohet në Rekomandimin CM/Rec(2010)5 të Këshillit të Europës, i cili rekomandon që shtetet anëtare, ndër të cilat Shqipëria, të integrojnë në legjislacionin kombëtar një përkufizim gjithëpërfshirës të gjinisë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe parimet e mbrojtjes nga diskriminimi lidhur me identitetin dhe shprehjen gjinore të kujtdo;
- Mbështetet gjerësisht nga Komiteti CEDAW;
- Është një koncept i konsoliduar në BE, falë jurisprudencës detyruese të Gjykatës Europiane të Drejtësisë (CJEU), si psh. në çështjet P v. S and Cornëall County Council (1996), VP (Hungary, C-247/23, 2025), C-247/23 (Deldits), ku theksohet se diskriminimi mbi bazë të identitetit gjinor përbën diskriminim mbi bazë seksi, duhet konsideruar si diskriminim dhe trajtim i pafavorshëm me bazë gjinore dhe duhet njohur nga legjislacionet që trajtojnë barazinë gjinore;
- Përputhet me standardet e KEDNJ-së (neni 14 lidhur me nenin 8), jurisprudencën e GJEDNJ-së, Konventën e Stambollit dhe gjetjet e grupit të saj të ekspertëve (GREVIO).



Parimet e barazisë dhe ndalimit të diskriminimit janë dy nga shtyllat themelore të rendit juridik të BE-së. Neni 10 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian¹ dhe nenet 2 dhe 3 të Traktatit për Bashkimin Evropian², sanksionojnë qartë se diskriminimi mbi bazë orientimi seksual dhe identiteti gjinor është i ndaluar. Po kështu, Karta e të Drejtave Themelore të BE-së, e cila ka të njëjtin status juridik si traktatet, në nenin 21 të saj ndalon shprehimisht diskriminimin mbi bazë orientimi seksual, dhe çdo interpretim institucional i bërë mbi të ka mbuluar identitetin dhe shprehjen gjinore³. Gjykata e Drejtësisë së BE-së në jurisprudencën e saj ka përcaktuar qartë se diskriminimi ndaj personave transgjinorë është diskriminim mbi bazë gjinore, prandaj duhet njohur nga legjislacionet që trajtojnë barazinë gjinore.

Në këtë kuptim, përfshirja e përkufizimit gjithëpërfshirës të “gjinisë” në projektligj nuk përbën risi ideologjike, por përmbush një standard ligjor të konsoliduar, duke siguruar që çdo qytetar, pavarësisht gjinisë apo karakteristikave identitare, të gëzojë mbrojtje të barabartë ligjore me çdo shqiptar e shqiptare tjetër.

Risitë e projektligjit:

Projektligji sjell një sërë dispozitash të reja që e bëjnë zbatimin e barazisë gjinore të matshëm dhe të detyrueshëm në praktikë, duke përfshirë:

- Përmbysjen e barrës së provës në përputhje me Direktivën 97/80/EC;
- Buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, gjuhën me ndjeshmëri gjinore, integrimin gjinor në politikat publike, pagën e barabartë për punë të barabartë, vlerësimin e punës së papaguar dhe mbledhjen e të dhënave gjinore;
- Masa të përkohshme dhe të veçanta për adresimin e pabarazive sistematike gjinore;
- Rregullimin e nëpunësit të dedikuar gjinor dhe forcimin e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore;
- Kompetenca të posaçme të Kuvendit për kontrollin post-legjislativ të zbatimit të ligjit;
- Rritjen progresive të përfaqësimit të grave nga 30 % në 50 % brenda një periudhe 10-vjeçare, në përputhje me Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 40 të CEDAW;

¹ **Article 10 TFEU:** “*In drafting, defining and implementing its policies and activities, the Union shall aim to combat discrimination based on ... **sexual orientation.***”

² **Consolidated version of the Treaty on European Union**, *Official Journal of the European Union*, OJ C 202, 7.6.2016.

³ Link:

<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=296550&pageIndex=0&doclang=EN&mode=req&dir=&occ=first&part=1&cid=9913715> (Vendim i muajit Mars 2025 i Gjykatës Europiane të Drejtësisë)



- Zgjerimin e mbrojtjes nga diskriminimi për shkak të gjinisë në sektorë ku pabarazitë janë më të dukshme (arsim, TIK, media, bujqësi, sport, mbrojtje sociale, transport, energji, mjedis, kulturë, art);
- Zgjerimin e sanksioneve administrative dhe të së drejtës për kompensim civil të dëmit jashtëkontraktor në rastet e trajtimit të pafavorshëm për shkak të pabarazisë gjinore.

Nëpërmjet këtyre dispozitave, projektligji garanton harmonizim me Acquis të BE-së dhe me detyrimet e Shqipërisë ndaj të drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për të, nën dritën e praktikave më të mira ndërkombëtare për avancimin e barazisë gjinore si parim ligjor, shoqëror dhe ekonomik.

Mbi konceptet thelbësore të barazisë moderne: “stereotipet gjinore” dhe “përkatësia e shumëfishtë”:

Një nga elementet më të rëndësishme që e dallon një ligj modern për barazinë gjinore nga një tekst formal është mënyra se si ky akt ligjor adreson stereotipet gjinore dhe përkatësinë e individëve. Këto dy koncepte nuk janë çështje semantike, por themele të së drejtës bashkëkohore për barazi, të pranuar gjerësisht si standarde të barazisë gjinore.

Stereotipet gjinore: Nga përkufizimi ligjor në synimin për transformim të shëndetshëm shoqëror

Ligji aktual për Barazinë Gjinore i vitit 2008 i përmend stereotipet gjinore tri herë, duke i njohur si shkak rrënjësor të pabarazive strukturore dhe si nevoja për adresim. Në projekt-amendamentet e reja të propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, ky term është fshirë plotësisht, nga tre përmendje në zero. Kjo shifër nuk pasqyron një rishikim teknik, por një ndryshim filozofie në luftën ndaj pabarazisë gjinore, që e zhvesh ligjin nga funksioni i tij edukativ dhe transformues.

Heqja e termit “stereotip gjinor” do të thotë që pabarazitë që lindin nga modelet kulturore dhe përfytyrimet tradicionale nuk do të njihen më si problem shoqëror e sistemik. Në praktikë, kjo do të thotë të mos i quash më problem faktet që vajzat shtyhen drejt profesioneve “për gra”, që burrat paragjykojnë kur kërkojnë leje prindërore, që gratë në politikë gjykojnë për pamjen dhe jo për idetë e tyre etj.

Pikërisht për të sfiduar këto realitete, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) në nenin 5 të saj i detyron shtetet ratifikuese, ndër të cilat

Shqipëria, të “modifikojnë modelet shoqërore dhe kulturore të sjelljes së burrave dhe grave”, ndërsa Deklarata e Pekinit (1995) e vendos eliminimin e stereotipeve gjinore në zemër të



barazisë faktike. Në të njëjtën frymë, Strategjia e Këshillit të Europës për Barazinë Gjinore 2024-2029 e lidh ndryshimin e stereotipeve dhe normave gjinore me forcimin e demokracisë dhe pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrje.

Përkatësia e shumëfishtë: realiteti i pabarazive që vijnë nga shkaqe të mbivendosura

Në mënyrë të ngjashme është sulmuar koncepti i “përkatësisë së shumëfishtë”, një nga elementet që i jep këtij ligji identitet dhe koherencë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Propozimet e fundit kërkojnë ta fshijnë plotësisht këtë koncept nga projektligji, duke e kthyer atë në një tekst që nuk njeh realitetin kompleks të shumë qytetarëve pjesë e shoqërisë shqiptare.

“Përkatësia e shumëfishtë” është koncept ligjor që buron dhe lidhet ngushtë me termin “diskriminim i shumëfishtë” dhe “diskriminim ndërsektorial”, të përmendura shprehimisht nga Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, duke kuptuar se një person mund të përjetojë diskriminim bazuar në më shumë se një shkak të mbrojtur. (Për shembull, si grua dhe rome, si grua me aftësi të kufizuara, si baba i vetëm, ose si vajzë e re nga zonat rurale). Në realitetin shqiptar, këto ndërthurje janë të zakonshme dhe të dukshme. Kur A. B, grua rome nga një zonë rurale, përjashtohet nga subvencionet dhe programet lokale apo kur M. L, grua lesbike me aftësi të kufizuara, përballet me stigmatizim dhe mungesë aksesimi në tregun e punës, ato nuk po trajtohen në mënyrë të pafavorshme në raport me pjesën tjetër të shoqërisë vetëm se janë gra, por edhe për të gjitha shkaqet e tjera të sipërpërmendura, çka e bën diskriminimin e tyre gjinor më kompleks dhe të ndërlidhur ngushtë me shkaqe të shumëfishta. Këto realitete nuk mund të injorohen nga ligji kryesor kombëtar që pretendon të adresojë efektivisht barazinë gjinore. Pa njohjen e konceptit të përkatësisë së shumëfishtë, këto raste komplekse bëhen juridikisht të padukshme.

Koncepti buron nga Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 28 i CEDAW, i cili e përkufizon diskriminimin gjinor si “të gjitha format dhe manifestimet e tij, duke përfshirë ato që lidhen me faktorë të tjerë ndërthurës”. Po kështu, Strategjia Evropiane për Barazinë Gjinore 2020-2025 dhe Agjenda 2030 e konsiderojnë qasjen ndërsektoriale si kusht për politika efektive dhe për reduktimin e pabarazive. Edhe Komisioni Evropian në raportet e progresit thekson se barazia gjinore nuk mund të ndahet nga dimensionet e tjera të pabarazisë ekonomike, etnike, kulturore apo të aftësisë sepse realiteti njerëzor nuk është i ndarë në kategori të izoluara.

Një ligj për barazinë gjinore nuk mund të jetë i verbër ndaj realitetit shoqëror të secilit qytetar që synon të mbrojë. Heqja e termave “stereotip gjinor” dhe “përkatësi e shumëfishtë” nuk është



çështje redaktimi, por një reduktim i vetë qëllimit të ligjit nga instrument transformimi në një tekst formal, pa marrë parasysh mënyrën se si pabarazia përjetohet në praktikë. Kjo do të sillte regres jo vetëm ndaj detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e të drejtave të njeriut (si kuadrit CEDAW, KEDNJ, Konventës së Stambollit, Agjendës 2030, standardeve evropiane të trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit) por edhe në raport me ligjin aktual të barazisë gjinore të vitit 2008, i cili në rast se këto projekt-amendamente miratohen do të përfaqësonte në këtë drejtim një instrument ligjor më progresiv sesa vetë projektligji i vitit 2025.

Çfarë përmirëson në praktikë Projektligji për Barazinë Gjinore?

Projektligji i vitit 2025 sjell një sërë përmirësimesh thelbësore, që siç e përmendëm më sipër, synojnë barazinë reale dhe jo vetëm formale, duke krijuar mekanizma konkrete për zbatim dhe llogaridhënie në praktikë:

- Përditëson Ligjin Nr. 9970/2008, duke përfshirë konceptet më të avancuara të mbrojtjes nga diskriminimi të trajtuara më sipër;
- Siguron mbrojtje më të plotë për gratë dhe burrat në vendin e punës, në sektorin publik dhe privat, kundër çdo forme diskriminimi në paga, promovim, trajnime apo kushte pune;
- Ndërthuret në mënyrë komplementare me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke krijuar një sistem të qartë koordinimi ndërinstucional për zbatimin e parimeve të barazisë gjinore;
- Forcon mekanizmat e llogaridhënies dhe monitorimit, duke krijuar mekanizma të qartë llogaridhënieje në të gjitha nivelet: ministri, institucione publike, bashki, media dhe sektor privat;
- Parashikon, se çdo institucion do të ketë zyra apo koordinatore të barazisë gjinore, të cilët raportojnë periodikisht për zbatimin e ligjit;
- Parashikon sanksione më të forta administrative për rastet e moszbatimit apo të diskriminimit të përsëritur;
- Këshilli i Ministrave ngarkohet me rishikim periodik të masave të përkohshme, për të siguruar që politikat e barazisë të kenë ndikim të matshëm;
- Njeh dhe vlerëson punën e papaguar të kujdesit, që shpesh kryhet nga gratë, por mbetet e padukshme në statistika dhe politika publike;



- Për herë të parë, kërkon që institucionet të zhvillojnë politika për ndarjen e drejtë të përgjegjësiwe familjare ndërmjet grave dhe burrave, përfshirë përmes shërbimeve komunitare, lejeve prindërore dhe nxitjes së balancës punë-jetë. Kjo qasje kontribuon në rritjen e mirëqenies së familjeve dhe në reduktimin e pabarazive ekonomike mes gjinive.
- Rritje e përfaqësimit të barabartë në vendimmarrje, duke ruajtur kuotën minimale ekzistuese prej 30% dhe duke synuar barazinë 50/50 brenda një periudhe 10-vjeçare;
- Promovon konkurrim të ndershëm, përfaqësim të balancuar dhe zhvillim të politikave të burimeve njerëzore me ndjeshmëri gjinore;
- Zbatim i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha nivelet e administratës publike, çka do të thotë që planifikimi, shpërndarja dhe monitorimi i fondeve publike duhet të marrin në konsideratë nevojat dhe ndikimet e ndryshme që kanë politikave mbi gratë dhe burrat;
- Ligji forcon edukimin për barazinë gjinore në shkolla, universitete dhe në sistemin e trajnimeve profesionale, duke nxitur respektin, dinjitetin dhe bashkëjetesën sociale. Ky proces nuk ndryshon konceptet e prindërimit apo të familjes, por ndihmon në formimin e brezave që kuptojnë barazinë si vlerë shoqërore dhe demokratike. Në këtë mënyrë, sistemi arsimor bëhet partner në parandalimin e dhunës, diskriminimit dhe stereotipeve gjinore;
- Ligji kërkon që të gjitha institucionet publike të përfshijnë objektiva për barazinë gjinore në strategjitë, buxhetet dhe raportet e tyre vjetore;
- Ministria përgjegjëse për barazinë gjinore do të ketë rol koordinues, mbikëqyrës dhe mbështetës për zbatimin e ligjit në të gjithë sektorët;
- Bashkëpunimi ndërmjet qeverisë, pushtetit vendor, institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile do të jetë thelbësor për zbatim efektiv, raportim transparent dhe llogaridhënie.

Çfarë NUK bën ky ligj?

Për të shmangur çdo keqinterpretim, nënvizojmë se projektligji në fjalë:

- **Nuk prezanton “gjiní të reja” dhe nuk zëvendëson biologjinë!**

Ligji nuk ndryshon konceptin biologjik të gjinisë, as nuk njeh “kategori të reja gjinore”. Për të prezantuar gjini të reja në shoqërinë shqiptare do të duheshin reforma të thella ligjore, duke nisur nga ndërhyrjet në Ligjin 10129/2009 “Për Gjendjen Civile” apo duke miratuar një kuadër



specifik ligjor për njohjen e identiteteve të reja gjinore. Projektligji mbetet në përputhje të plotë me terminologjinë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila mbron çdo person nga diskriminimi pa cenuar nocionet biologjike.

- **Nuk ndërhyt në jetën familjare dhe nuk ndryshon konceptet “nënë”, “baba” apo “prind”!**

Projektligji nuk prek strukturën e familjes, nuk ndryshon rolet prindërore dhe nuk rishkruan konceptet themelore të prindërimit. Përkundrazi, ai e sheh familjen si qelizën themelore të shoqërisë shqiptare dhe synon ta mbështesë atë përmes masave që mbrojnë nënat në punë, u japin baballarëve më shumë të drejtë për të marrë pjesë në kujdesin ndaj fëmijëve dhe lehtësojnë përgjegjësitë familjare përmes politikave të reja sociale. Kjo qasje është në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës që njeh dhe mbron specifikisht familjen, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që garanton respekt për jetën private dhe familjare.

- **Nuk imponon terminologji, sjellje apo “gjuhë ideologjike”!**

Ligji nuk detyron askënd të ndryshojë mënyrën e të folurit apo të shprehjes, por kërkon që institucionet shtetërore dhe dokumentet zyrtare të përdorin gjuhë me ndjeshmëri gjinore, pra një gjuhë respektuese, përfshirëse dhe jo ofenduese. Kjo do të thotë se në aktet publike, praktikat dhe materialet edukuese duhet të përdoren forma gjuhësore që i përfshijnë të dyja gjinitë, p.sh. “kandidatët/kandidatet”, “punonjësit/punonjëset”. Ky është standard ndërkombëtar i miratuar nga Këshilli i Europës dhe BE-ja, që synon respekt dhe përfaqësim të barabartë, jo imponim ideologjik.

- **Nuk mbivendoset me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi!**

Projektligji nuk e zëvendëson dhe nuk bie ndesh me Ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Përkundrazi, ai e plotëson këtë kuadër duke përcaktuar rregulla të qarta për zbatimin institucional të parimit të barazisë gjinore, duke përcaktuar rolet e ministrive, institucioneve vendore, mediave dhe sektorit privat. Në këtë mënyrë, të dy ligjet funksionojnë në harmoni dhe në mënyrë komplementare, duke mbuluar si mbrojtjen individuale nga diskriminimi edhe krijimin e politikave institucionale për barazi sistematike dhe llogaridhënie.

- **Nuk cënon sportin, fenë apo identitetin kombëtar!**

Ligji nuk ndërhyt në mënyrën e organizimit të sportit, në doktrinën fetare, apo në simbolet kombëtare të Shqipërisë. Përkundrazi, ai mbështetet mbi parimet e respektit të dinjitetit njerëzor dhe mosdiskriminimit, të sanksionuara në Kushtetutë (neni 3 dhe neni 18) dhe në



Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 14- ndalimi i diskriminimit). Kuadri ynë ligjor i njeh komunitetet fetare, organizatat sportive dhe entet kulturore si pjesë të rëndësishme të jetës shoqërore shqiptare, duke kërkuar nga to vetëm respekt ndaj barazisë dhe mosdiskriminimit.

➤ **Nuk imponon “ideologji të reja”, por forcon parime ekzistuese!**

Projektligji nuk imponon ideologji të huaja apo koncepte që bien ndesh me traditat shqiptare. Ai është ndërtuar mbi vlerat e respektit, drejtësisë, solidaritetit dhe dinjitetit njerëzor, të cilat janë pjesë e identitetit kombëtar dhe kulturor të Shqipërisë. Në thelb, ligji forcon atë që shoqëria shqiptare ka mbështetur gjithmonë: respektin për tjetrin dhe drejtësinë për të gjithë.

Pse ky ligj është i nevojshëm sot?

Në vitin 2025, Shqipëria përballet ende me pabarazi strukturore gjinore që kufizojnë zhvillimin e plotë të shoqërisë dhe potencialin ekonomik të vendit. Pavarësisht përparimeve të rëndësishme gjatë dekadës së fundit, gratë dhe burrat në Shqipëri nuk kanë ende mundësi të barabarta për të ndërtuar një jetë dinjitoze, për të ndikuar në vendimmarrje dhe për të përfituar në mënyrë të drejtë nga rritja ekonomike e vendit.

Pabarazitë ekonomike dhe sociale:

Gratë përbëjnë më shumë se gjysmën e popullsisë, por kanë pjesëmarrje më të ulët në tregun e punës, shpesh të përqendruar në sektorë me paga të ulëta dhe siguri të kufizuar. Ato kryejnë pjesën më të madhe të punës së papaguar të kujdesit për fëmijët, të moshuarit dhe familjen, një punë e padukshme në statistika ekonomike, por që është jetike për funksionimin e çdo ekonomie. Kjo ngarkesë e pabarabartë u kufizon grave mundësitë për arsimim, zhvillim profesional dhe pavarësi ekonomike.

Pabarazitë në vendimmarrje dhe përfaqësim:

Në institucionet publike, politikat vendimmarrëse dhe bordet drejtuese, gratë mbeten të nën-përfaqësuara. Edhe pse kuota ligjore 30% ka ndihmuar në përmirësim të pjesëmarrjes në Kuvend e bashki, barazia e plotë 50/50 ende nuk është realitet. Mungesa e grave në pozita kyçe ndikon në kualitetin e politikave publike, sepse përvojat dhe nevojat e gjysmës së popullsisë nuk reflektohen mjaftueshëm në vendimmarrje.

Pabarazitë në shpërndarjen e mundësive:



Në shumë fusha, si arsim, shëndetësi, administratë, media dhe biznes, stereotipet gjinore dhe mungesa e politikave të barazisë pengojnë zhvillimin e potencialit të plotë njerëzor.

Shpesh, gratë përballen me pengesa të padukshme për avancim profesional, ndërsa burrat ndihen të kufizuar nga pritshmëritë tradicionale që i lidhin me rolin e vetëm si “sigurues ekonomik”.

Ky sistem i vjetëruar dëmton si gratë ashtu edhe burrat, dhe krijon një shoqëri të pabarabartë dhe më pak produktive.

Nevoja për zbatim real dhe mekanizma konkretë:

Ligji i vitit 2008 vendosi themelet e barazisë gjinore, por mungesa e mekanizmave të fortë të zbatimit dhe monitorimit bëri që shumë dispozita të mbeten në letër. Në një realitet të ri ekonomik dhe social, është e domosdoshme që ligji të modernizohet, konkretizohet dhe zbatohet me përgjegjësi të qartë institucionale. Vetëm në këtë mënyrë barazia gjinore mund të kthehet nga parim ligjor në praktikë të përditshme.

Barazia gjinore nuk është vetëm çështje drejtësie shoqërore, por kusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Studimet e BE-së dhe OECD-së tregojnë se ekonomitë që garantojnë barazi më të madhe gjinore arrijnë rritje më të shpejtë, më shumë inovacion dhe më pak varfëri. Çdo grua që ka mundësi të kontribuojë në ekonomi dhe çdo burrë që ndan përgjegjësitë familjare, shton vlerë në mirëqenien e përbashkët.

Në përfundim, ky projektligj është i nevojshëm sepse barazia gjinore nuk është luks, por domosdoshmëri për një Shqipëri moderne, demokratike dhe europiane. Ai u jep grave dhe burrave mundësi të barabarta për të ndërtuar një jetë me dinjitet, për të kontribuar në zhvillimin e familjes, komunitetit dhe vendit, dhe për të përmbushur idealin kushtetues të një shoqërie të lirë, të drejtë dhe të barabartë për të gjithë.

Thirrje për mbështetje:

Në përfundim të këtij materiali informues, ftojme çdo anëtar dhe anëtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të lexojë me kujdes përmbajtjen e këtij projektligji dhe të mos lejojë që zhurma, keqinformimi dhe fushatat e frikës ta errësojnë thelbin e tij të drejtë, njerëzor dhe shoqëror. Ky projektligj që flet për familjet shqiptare, për drejtësi sociale, për shanse të barabarta dhe për një Shqipëri më të drejtë, më të ndershme dhe më dinjitoze për të gjithë qytetarët e saj nuk mund të portretizohet si dëmi më i madh që po i ndodh shoqërisë shqiptare. Ky nuk është një ligj për ndarje, por për bashkim; nuk është ideologji, por reflektim i sfidave të dinjitetit njerëzor; nuk synon të ndajë gratë nga burrat, por t'i bëjë ata aleatë dhe bashkëudhëtarë më të mirë në barazi dhe respekt.



4. DEKLARATË PUBLIKE E ORGANIZATAVE TË GRAVE

Drejtuar:

- Z. Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë - Kryetar i Partisë Socialiste
- Z. Niko Peleshi, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë
- Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë

Ne, organizatat e grave dhe të të drejtave të njeriut, shprehim shqetësimin e thellë për përpjekjet e vazhdueshme për të dobësuar **Projektligjin për Barazinë Gjinore**, i cili pasqyron **rreth tre dekada sakrificë, punë lobimi dhe advokimi të grave shqiptare** për barazi dhe drejtësi shoqërore.

Ky ligj:

- **forcon barazinë gjinore** në punë, arsim, shëndetësi, shërbime sociale dhe vendimmarrje;
- **adreson stereotipet gjinore**, promovon përdorimin e gjuhës me ndjeshmëri gjinore dhe kërkon vlerësim të ndikimit gjinor në çdo ligj;
- **mbroton të drejtat e individëve**, duke harmonizuar legjislacionin kombëtar me standardet e BE-së dhe rekomandimet e konventave ndërkombëtare;
- **nuk krijon gjini të reja**, nuk ndryshon jetën familjare dhe nuk imponon terminologji të detyrueshme mbi qytetarët.

Ne shprehim **shqetësimin e veçantë** për faktin se amendimet e propozuara nuk mund të jenë pjesë e një ligji që synon **barazi dhe respekt të të drejtave të njeriut**. Çdo ndryshim që minon këto parime **do të ishte një hap prapa për shoqërinë shqiptare**, pavarësisht sfidave dhe vështirësive globale.

Ne kërkojmë:

1. **Miratimin e ligjit në formën e plotë** të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në konsultim me të gjitha grupet e interesit, **ku përfshihemi edhe ne**, pa ndryshime që çënojnë barazinë gjinore;



2. **Debat të hapur dhe transparent me pjesëmarrjen e ekspertëve të të drejtave të njeriut dhe shoqërisë civile;**
3. **Mbështetjen publike të përkushtimit ndaj barazisë, dinjitetit dhe të drejtave të njeriut si themel i integritetit evropian dhe demokracisë në Shqipëri.**

Çdo pengesë apo dobësim i ligjit me kërkesë nga grupe të caktuara nuk duhet të na shenjojë si shoqëri dhe është një kërcënim për përparimin e mundimshëm 30-vjeçar të grave shqiptare.

5. KONFERENCË PËR SHTYP PËR LIGJIN E BARAZISË GJINORE

KONFERENCË PËR SHTYP

Ju ftojmë të merrni pjesë në Konferencën për Shtyp që do të zhvillohet në kuadër të debatit publik mbi Projektligjin “Për Barazinë Gjimore”. Një nismë që synon forcimin e drejtësisë, respektit dhe mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët.



21 Tetor 2025



15:00



Hotel Rogner

Kjo konferencë synon të sqarojë opinionin publik dhe median mbi qëllimin real të projektligjit – një ligj për drejtësi, dinjitet dhe familjet shqiptare, i ndërtuar mbi vlerat kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.



6. PJESËMARRJE NË KOMISIONIN PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE MJETET E INFORMIMIT PUBLIK NË KUVENDIN E SHQIPËRISË



7. PJESËMARRJE NË KOMISIONIN PËR SHËNDETËSINË DHE MIRËQËNIEN SOCIALE NË KUVENDIN E SHQIPËRISË





8. LETËR PRESIDENTIT LIDHUR ME DEKRETIMIN E LIGJIT “PËR BARAZINË GJINORE”

Tiranë, 12.11.2025

Z. Bajram Begaj

President i Republikës së Shqipërisë

Tiranë

Lënda: Shprehje opinionit formal dhe kërkesë lidhur me dekretimin e Ligjit “Për Barazinë Gjinore” 2025.

I nderuar Z. President,

Ne, përfaqësueset dhe përfaqësuesit e organizatave për të drejtat e njeriut në Shqipëri, Ju drejtohem me respekt dhe përgjegjësi qytetare për të shprehur opinionin formal dhe kërkesën tonë mbi dekretimin e Ligjit “Për Barazinë Gjinore” 2025, i votuar dhe miratuar së fundmi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Ky ligj është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, konkretisht me nenet 5, 17, 18, 116 dhe 122 të saj, të cilat: garantojnë zbatimin dhe përparësinë e aplikimit të së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë; garantojnë moskufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut përtej standardeve të vendosura nga sistemi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe përcaktojnë se barazia dhe mosdiskriminimi janë garanci kushtetuese, duke përkufizuar qartë detyrimin e shtetit tonë për të siguruar zhvillimin e barabartë të grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike, kulturore dhe shoqërore.

I bazuar në këto parime kushtetuese që udhëheqin rendin juridik shqiptar, ligji “Për Barazinë Gjinore” 2025 përbën një hap thelbësor drejt arritjes së barazisë thelbësore dhe jo vetëm formale lidhur me mundësitë dhe trajtimin e drejtë për të gjithë qytetarët shqiptarë, gra dhe burra, pa kurrfarë dallimi dhe diskriminimi.

Në vijim, ju parashtrijmë opinionin tonë formal dhe kërkesën lidhur me rëndësinë e dekretimit të këtij ligji.

Ky ligj plotëson kornizën legislative të vendit tonë, duke e sjellë atë në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe Acquis të Bashkimit Europian. Gjejmë me



vend të sqarojmë, pavarësisht fushatës masive të dizinformimit që ka shoqëruar këtë ligj kaq të rëndësishëm, se ai është në përputhje të plotë me:

- Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës;
- Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Çdo Forme Diskriminimi ndaj Grave (CEDAW);
- Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 40 të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Çdo Forme Diskriminimi ndaj Grave (CEDAW, 2024) për përfaqësimin e barabartë në vendimmarrje;
- Konventën e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) dhe gjetjet e Grupit të Ekspertëve të Këshillit të Europës për Veprime kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) të vitit 2024 për Shqipërinë;
- Konventën nr. 190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës;
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (OZHQ 1, 3, 5, 6, 10, 11, 16);
- Acquis të Bashkimit Europian, përfshirë Direktivën 2000/78/EC, Direktivën 2006/54/EC, Direktivën 75/117/EEC, Direktivën 76/207/EEC dhe Direktivën 97/80/EC, që vendosin standardet e trajtimit të barabartë, pagës së barabartë dhe përmbysjen e barrës së provës;
- Kartën për të Drejtat Themelore të BE-së (nenet 20-38); Traktatin e Bashkimit Europian (TBE) dhe Traktatin për funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE);

Ligji siguron harmonizim horizontal të standardeve të mbrojtjes ligjore me legjislacionin kombëtar të pas vitit 2008 (miratuar ose ndryshuar), përfshirë Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”; Ligjin “Për Buxhetin e Shtetit”, Ligjin “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Kodin e Punës dhe Kodin e Mediave Audiovizive, Ligjin “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” dhe Ligjin “Për Inspektimin Shtetëror”, duke garantuar koherencë mes instrumentave ligjore e institucionale dhe efektivitet në zbatim.

Hyrja në fuqi dhe zbatimi i këtij ligji do të ndikojë drejtpërdrejt në:

- Rritjen e përfaqësimit të grave në institucionet publike dhe private;



- Forcimin e mekanizmave institucionalë për integrimin e perspektivës gjinore dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në politikat publike;
- Zhvillimin e një administrate më gjithëpërfshirëse dhe transparente mbi bazat e barazisë gjinore;
- Garantimin e mbrojtjes së barabartë në punë dhe krijimin e kushteve të sigurta profesionale për të gjitha gratë dhe burrat;
- Përfshirjen e edukimit dhe trajnimit mbi barazinë gjinore në sistemet e formimit profesional dhe publik;
- Përmirësimin e treguesve të demokracisë dhe sundimit të ligjit, në përputhje me standardet e vlerësimit të Komisionit Europian dhe rekomandimet e Bashkimit Europian për vendet kandidatë.

Ky ligj, i cili është përgatitur me pjesëmarrjen e gjerë të të gjithë institucioneve dhe organizatave të interesuara, si dhe është dakorduar me institucionet përgjegjëse të Bashkimit Europian dhe të OKB-së, tashmë është votuar dhe miratuar në një proces transparent dhe të rregullt nga shumica e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.

Ne, përfaqësuesit e organizatave të të drejtave të njeriut, nënshkruese të këtij opinioni formal dhe kërkesës sonë, inkurajojmë dekretimin e këtij ligji nga Ju dhe hyrjen e tij në fuqi sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të nisë zbatimin e tij, për ta çuar përpara barazinë gjinore, e cila nuk është vetëm një çështje e drejtësisë sociale, por me ndikim në rritjen ekonomike, përmirësimin e qeverisjes dhe përforcimin e institucioneve në vendin tonë. Zbatimin e këtij ligji do të ndihmojë, po ashtu, në adresimin e rekomandimeve të përsëritura nga institucione ndërkombëtare si Komitetet CEDAW dhe GREVIO për Shqipërinë lidhur me vonesën në kryerjen e reformave në fushën e barazisë gjinore.

Duke u mbështetur në parashtrimet e mësipërme, me respekt, kërkojmë nga Ju:

- Dekretimin e ligjit “Për barazinë gjinore” 2025, në fuqi pa vonesë;
- Të apeloni përkundrejt institucioneve përgjegjëse që të përgatisin pa vonesë aktet nënligjore dhe procedurat e zbatimit të këtij ligji.
- Të mbështesni publikisht mbështetjen tuaj për ligjin dhe rëndësinë e tij për barazinë midis burrave dhe grave në shoqëri, një mesazh ky tepër i rëndësishëm për mobilizim institucional dhe shoqëror.



Ne besojmë, se vendimi Juaj për dekretim do të jetë një mesazh i fuqishëm, i cili do të rezonojë brenda dhe jashtë vendit, se barazia gjinore është prioritet kombëtar në Shqipëri dhe jo vetëm një akt deklarativ.

Me besim për bashkëpunim të mëtejshëm dhe me përkushtim të plotë, Ju falënderojmë paraprakisht për vëmendjen dhe rolin Tuaj lidhur me këtë çështje thelbësore për shoqërinë shqiptare.

9. FUSHATË ONLINE



**Ka shumë dezinformim
mbi ligjin për barazinë
gjinore.**

Ja disa të vërteta.



10. DALJE MEDIATIKE

Ligji për Barazinë Gjinore në Shqipëri: Tani ta shohim të vihet në zbatim

Dezinformimi online nga kundërshtarët e ligjit të ri për barazinë gjinore nuk duhet të errësojë çështjen e vërtetë: ky legjislacion jetik u miratua nga parlamenti, por tani kemi nevojë që ai të funksionojë në praktikë, jo vetëm në letër.

Nga [Ines Leskaj](#) — 10:39 | 10/11/2025 Në [Opinion](#) Kohe leximi: 5 minuta

AA 0



11. KRIJIMI I KOALICIONIT PËR BARAZINË GJINORE DHE FAMILJEN

Më 20 janar 2026, në kuadër të zhvillimeve të fundit që prekin barazinë gjinore dhe të drejtat themelore në Shqipëri, Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) dhe Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (GADC) organizuan një takim me organizata të tjera të shoqërisë civile për të diskutuar përpjekjet për shfuqizimin e Ligjit nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore” dhe ndërtimin e një qasjeje të përbashkët strategjike për mbrojtjen e ligjit dhe kauzës së barazisë gjinore në Shqipëri.

Organizatat pjesëmarrëse:



1. Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (GADC)
2. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)
3. Aleanca LGBT
4. Ambasada Britanike
5. Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)
6. Instituti për Zhvillim dhe Inisiativa Qytetare (IZHIQ)
7. Parters Albania
8. Q.P.S. Vatra
9. Qendra “Sot për të Ardhmen”
10. Qendra “Strehëza Edlira Haxhiymeri”
11. Qendra e Shkencës dhe Inovacionit për Zhvillim (SCIDEV)
12. Qendra për Drejtësi Gjinore
13. Qendra për Nisma Ligjore (QNL)
14. Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA)
15. Qendra për të Drejtat në Punë
16. Rrjeti “Barazi në Vendimmarrje”
17. Shërbimi Ligjor Falas TLAS
18. Shoqata Gender Paqja siguria
19. Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë (SHKBSH)
20. Të Ndryshëm Të Barabartë
21. Un RCO
22. UN Women
23. WFD Albania
24. YWCA Albania

Në këtë kuadër, organizatat pjesëmarrëse u angazhuan në ndërtimin e një qasjeje të përbashkët, duke e konsideruar të domosdoshëm krijimin e një koalicioni të gjerë që do të



bashkojë aktorët kryesorë të shoqërisë civile, ekspertët dhe partnerët ndërkombëtarë. Ky koalicion synon të shërbejë si një platformë e përbashkët për koordinimin e veprimeve, shkëmbimin e informacionit dhe rritjen e ndikimit në mbrojtje të barazisë gjinore dhe të drejtave themelore. Përmes këtij bashkëpunimi, synohet të kapërcehen fragmentimet ekzistuese dhe të ndërtohet një zë më i fortë dhe më i unifikuar në nivel publik dhe institucional.

Koalicioni u quajt: Koalicioni për Barazinë Gjinore dhe Familjen.

U hapën faqe në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram, të cilat do të përdoren për informim dhe edukim.





12. Kërkesë ndaj AMA për verifikimin dhe marrjen e masave për përhapjen e informacionit të rremë në median audiovizive lidhur me LBGJ

Tiranë më 19.03.2026

Kërkesë

Drejtuar: Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)

Subjekti: Kërkesë për verifikimin dhe marrjen e masave për përhapjen e informacionit të rremë në median audiovizive lidhur me ligjin nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”

Të nderuar,

Ky reagim paraqitet në mbështetje të parimeve të shtetit të së drejtës dhe të së drejtës së publikut për informim të saktë, në kuadër të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për median audiovizive dhe standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes dhe përgjegjësinë mediatike, dhe të detyrimin që veprimtaria e transmetimeve audiovizive të garantojë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit gjinor, ndalimit të seksizmit në media.

Nga analiza e përmbajtjeve të transmetuara në disa shërbime mediatike audiovizive rezulton se janë përhapur pretendime të pabazuara juridikisht në lidhje me ligjin nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”. Konkretisht, ky ligj është paraqitur në mënyrë të vijueshme si një akt që synon krijimin apo njohjen e gjinive të tjera përtej burrë dhe grua dhe cenon institucionin e familjes. Ky qëndrim i referohet një aspekti/rregullimi që nuk ekziston në tekstin ligjor. Këto pretendime nuk gjejnë asnjë mbështetje në përmbajtjen normative të ligjit dhe përbëjnë një formë të qartë të dezinformimit publik. Ligji nr. 64/2025 synon garantimin dhe forcimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave, në përputhje me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë detyrimet që rrjedhin nga Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).⁴ Sipas standardeve ndërkombëtare, promovimi i barazisë gjinore nuk cenon institucionin e familjes, por kontribuon në forcimin e tij mbi baza të barazisë, dinjitetit dhe respektit të ndërsjellë.⁵

⁴ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (miratuar më 18 dhjetor 1979, hyrë në fuqi më 3 shtator 1981) 1249 UNTS 13.

⁵ Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 21: Barazia në martesë dhe marrëdhëniet familjare (1994).



Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive janë të detyruar të respektojnë parimet e informimit të saktë dhe të përgjegjshëm. Në veçanti:

- Neni 4 parashikon parimet themelore të veprimtarisë audiovizive, duke përfshirë detyrimin që veprimtaria e transmetimeve audiovizive të sigurojë informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit, sikurse veprimtaria e transmetimeve audiovizive të garantojë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit gjinor, ndalimit të seksizmit në media dhe përfaqësimit gjinor në median audiovizive në përputhje me legjislacionin në fuqi;⁶
- Neni 33 kërkon që programet informative të respektojnë kriteret e vërtetësisë, paanshmërisë, objektivitetit, dhe të mos cenojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;⁷

Në këtë kontekst, përhapja e informacionit të pavërtetë mbi përmbajtjen e një ligji përbën shkelje të drejtpërdrejtë të këtyre dispozitave, pasi:

- shtrembëron realitetin juridik;
- cenon të drejtën e publikut për informim të saktë;
- ndikon negativisht në formimin e opinionit publik mbi çështje të interesit të lartë sic janë ato të të drejtave themelore të njeriut, dhe posacërisht të barazisë gjinore mes burrave dhe grave, sic parashikohet në ligjin nr. 64/2025.

Sipas standardeve të zhvilluara në jurisprudencën evropiane, liria e shprehjes shoqërohet me detyrime dhe përgjegjësi, veçanërisht në kontekstin e informimit publik mbi çështje me interes të përgjithshëm.⁸

Në dritën e sa më sipër, përhapja e pretendimeve të pavërteta mbi ligjin nr. 64/2025 përbën një devijim nga standardet e informimit të vërtetë, një formë të dezinformimit që cenon interesin publik, që cenon të drejtat themelore të njeriut dhe si rrjedhojë një praktikë që legjitim ndërhyrjen rregullatore të AMA-s në ushtrim të kompetencave të saj ligjore.

Garantimi i një mjedisi mediatik të bazuar në saktësi dhe përgjegjësi është thelbësor për funksionimin e demokracisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Dezinformimi mbi përmbajtjen e një ligji që synon barazinë gjinore jo vetëm që cenon publikun, por rrezikon edhe cilësinë e debatit demokratik.

Për sa më sipër, kërkohet nga Autoriteti i Mediave Audiovizive:

1. Të kryejë monitorimin dhe verifikimin e përmbajtjeve mediatike ku janë përhapur informacionet e pasakta;

⁶ Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4.

⁷ Po aty, neni 33.

⁸ Çështja *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1976) 1 EHRR 737, § 49; *Delfi AS kundër Estonisë* (2015) 62 GJEDNJ 6.



2. Të konstatojë referimet e shtrembëruara, referuar ligjit nr. 97/2013, veçanërisht të neneve 4 dhe 33;
3. Të marrë masat administrative përkatëse ndaj subjekteve përgjegjëse;
4. Të forcojë mekanizmat e mbikëqyrjes për parandalimin e dezinformimit në çështje që lidhen me të drejtat themelore të njeriut dhe posacërisht barazinë gjinore.

LINK:

https://www.youtube.com/watch?v=Gk-7m_9fwy8

(Diskutimi për Ligjin e sipërpërmendur fillon pas min 35.00.)

Ju falenderojmë parapikisht për vëmendjen tuaj.

Me respekt,

Koalicioni për Barazinë Gjinore dhe Familjen

13.TAKIME URGJENTE ADVOKACIE DHE AMICUS CURIAE

AWEN, së bashku me partnerë si GADC, nisi gjithashtu takime urgjente advokacie me institucione kyçe, përfshirë Delegacionin e BE-së, Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Përveç kësaj, AWEN bashkë-udhëhoqi përgatitjen e një dokumenti *Amicus Curiae* për Gjykatën Kushtetuese, duke ofruar analizë ligjore në mbështetje të Ligjit për Barazinë Gjinore.